

PROGRAMI I SUKSESIT TË PRINDËRVE (PARENT SUCCESS PROGRAM)

Reduktimi i detyrimeve ndaj qytetit të Nju-Jorkut me anë të punësimit

Fotografia është e një modeli të përdorur
vetëm për qëllime ilustruese.

Nëse merrni pjesë në një program të kualifikuar punësimi të Department of Social Services, mund të reduktoni detyrimin tuaj të mbështetjes financiare për fëmijën me **deri në \$7,500**.

A vlejnë të treja pikat për ju?

- 1 Keni detyrime të mbështetjes financiare për fëmijën ndaj Department of Social Services (DSS) të qytetit të Nju-Jorkut;
- 2 Jeni regjistruar në një program të kualifikuar punësimi të DSS-së; dhe
- 3 Keni filluar punë dhe pagesat tuaja të mbështetjes financiare për fëmijën janë zbritur nga paga juaj për të paktën tre muaj (kjo quhet “mbajtje e të ardhurave”).

Nëse të treja pikat vlejnë për ju, atëherë Office of Child Support Services (OCSS) në Qytetin e Nju-Jorkut mund të reduktojë detyrimin e përhershëm të mbështetjes financiare për fëmijën që i detyroheni DSS-së së qytetit të Nju-Jorkut **me deri në \$7,500**.

Keni pyetje?

Referojuni Pyetjeve më të shpeshta (Frequently Asked Questions, FAQs) për më shumë informacion rreth programeve të kualifikueshme të punësimit: <https://nyc.gov/ocss-debt-reduction>.

Pyesni stafin e programit tuaj të punësimit të DSS-së rreth “Programit të Suksesit të Prindërve” të OCSS-së ose kontaktoni OCSS-në me email, fizikisht ose me postë. Vizitoni faqen <https://on.nyc.gov/contactocss>.